

Titulli i lëndës: Hyrje në misticizmin islam

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Hyrje në misticizmin islam
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Lëndë zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Zeqije Xhafce
Të dhënat kontaktuese:	Email: zekije.xhafqe@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Ky kurs ofron një studim fillestar i misticizmit Islam, i njohur si tasavvuf. Objekti i studimit do të jenë idetë, praktikat dhe institucionet themelore të kësaj tradite si dhe ndikimi i tasavvufit në letërsinë dhe shoqërinë Islame. Kursi mbështetet në njohurinë paraprake mbi Islamin dhe kulturën Islame të përfituar në kurset e tjera të parapara siç janë “Historia e Islamit”, “Qytetërimi Islam” ku do të njoftohen me doktrinat themelore të Islamit. Kursi është i përshtatshëm për ata që dëshirojnë të përfitojnë njohuri themelore në lidhje me dimensionet mistike të traditës Islame si dhe për ata që dëshirojnë të specializohen në disa fusha të ndryshme siç janë studimet e Islamit, studimet e Lindjes së Mesme ose studimet krahasimore të religjioneve.</p> <p>Kursi do të ndahet në tri pjesë:</p> <p>Në pjesën e parë do të trajtohet shtrirja e sufizmit në mjedisin musliman dhe zhvillimi historik.</p> <p>Në pjesën e dytë do të prezantohen temat themelore në mendimin sufizmit.</p> <p>Dhe pjesa e tretë ku do të trajtohet Sufizmi dhe Letërsia.</p>

Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që studenti të mund të njohë konceptet dhe proceset e zhvillimit të temave themelore të mendimit mistik në Islam. Të njoftohet me konceptet e tasavvufit, zhvillimin historik dhe veprat letrare të tasavvufit. T'i prezantohen studentit mendimet tradicionale islame në përfaqësim me traditën e sufizmit. Duke marrë informacione nga dy burime të krijojë mendimin personal kritik mbi traditën e sufizmit në përgjithësi.
--------------------	---

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde studenti :
	- definon sufizmin dhe sufiun
	- përshkruan dimensionet mistike të islamit
	- krahason koncepte e ndryshme të sufizmit me doktrinat e Islamit të cilat i studion gjatë kursit
	- diskuton rreth tematikave të sufizmit siç janë praktikat, zikri, sema dhe ndikimin e sufizmit në letërsi dhe shoqëri
	- zbaton njohuritë e fituara në relacionin ndër shoqëror.
	- vlerëson burimet e krizave politike dhe sektare në Lindjen e Mesme.
	- Mëson terminologjinë e sufizmit

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	4	8
Konsultime me mësuesin	10 min	15	2.5
Puna në terren			

Testi, punimi i seminarit	3	10	30
Detyrë shtëpie	1	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	6	18
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.5
Total			149 orë 149/25=5.96 6 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	<p>Përveç dy orë ligjëratave në javë, studenti do të shkruajë nga një ese për secilën pjesë tematike të kursit, ku do t'i krahasojë qëndrimet e ndryshme të studiuesve në tema përkatëse. Kuptimi i fjalës „ese“ është „provë, përpjekje“. Prandaj, qëllimi i kësaj detyre është që studenti t'i „provojë“ mendimet e tij në lidhje me tekstet e përcaktuara me lirin e zgjedhjes së mënyrës së menduarit. Gjatë diskutimeve që do të zhvillohen në fund të orës, studentët do kenë mundësi të njihen me shkrimet e poetëve dhe shkrimtrëve të sufizmit Islam. Kurse në disa orë gjatë semestrit, do të lexohen tekste nga sufizmi islam dhe do bëhet interpretimi i lirë i tyre. Studentët duhet të inkurajohen të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike, hulumtuese dhe shkencore.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Kollokviumi 30% Provimi final 60%.</p>		
Literatura primare:	<p>Martin Lings, Çfarë është Sufizmi?, Logos A, përktheu Edin Lohja, 2010, Prishtinë-Shkup Annemarie Schimmel, Mystical Dimensions of Islam, The University of North Carolina Press, 1975</p>		
Literatura shtesë:	<p>Metin Izeti, Kllapia e Tesavvufit, BFI-FSHI, Shkup 2004 William Chittick, Sufi Path of Knowledge, State University of New York Press, 1989, Albany Eva de Vitray-Meyerovitch, Antologjia sufijskih tekstova, Naprijed, Zagreb, 1988</p>		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në Misticizmin Islam: Çka është Sufizmi? Kush është Sufi?
Java 2:	Burimet e traditës: Kurani, Hadithi dhe profeti Muhammed (sav) si paradigma e jetës shpirtërore
Java 3:	Njohja me konceptet themelore të sufizmit. Rruga. Terminologjia dhe karakteristikat e tasavvufit: termet e gjendjeve dhe pozicionimeve sufike. Dashuri dhe anihilimi. Format e adhurimit
Java 4:	Njeriu dhe Përsosmëria e tij. Shejhi Sufi si mentor, udhërrëfyes dhe autoritet fetar në Islam. Termet psikologjike të tasavvufit. Koncepti i të mires dhe të keqës.
Java 5:	Diskutim (prezantimi i eseve)
Java 6:	Zhvillimi historik i Sufizmit klasik. Jeta në bashkësi. Tarikatet e para. Tarikatet, teqet dhe zavijet.
Java 7:	Disa liderë mistik të shekullit të 9-të : Al Hallaj, martir i Dashurisë mistike
Java 8:	Periudha e konsolidimit Nga Shibliu te Ghazzali
Java 9:	Ibn Arabiu dhe sufizmi teozofik
Java 10:	Diskutim (prezantimi i eseve)
Java 11:	Sufizmi dhe Letërsia. Poezia mistike turke dhe perse
Java 12:	Feriduddin Attar : “ Mantiku’ t –Tayr”
Java 13:	Mevlana Rumi: “Fihi ma Fih”a
Java 14:	Yunus Emre dhe Divani i tij
Java 15:	Diskutim (prezantimi i eseve)

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.

